

## **Dr. Petrit Gashi**

Profesor i asociuar

Fakulteti Ekonomik

Universiteti i Prishtinës

Kati 7, zyra 84

[petrit.gashi@uni-pr.edu](mailto:petrit.gashi@uni-pr.edu)

## **EKONOMIKSI I TRANZICIONIT**

### **Përmbajtja e shkurtër e lëndës:**

Lënda e ekonomiksit së tranzicionit mbulon transformimet ekonomike të vendeve të ish bllokut socialist. Mësimi fillon me një pershkrim të shkurtër të shtyllave kryesore të sistemit socialist, duke diskutur në vijim faktorët që sollën deri te rënia e këtij sistemi. Pjesa tjetër e mësimit koncentrohet në aspektet bazike të reformave stabilizuese dhe strukturore me qëllim të ndërtimit të një ekonomie të tregut. Në mënyrë specifike, lënda mbulon aspektet ne vijim:

- Origjina e sistemit komunist dhe karakteristikat kryesore të tij;
- Tentativat për reforma dhe rënia përfundimtare e sistemit komunist;
- Efektet e rënies së sistemit dhe 'recesioni transformues';
- Strategjitë dhe agjenda transformuese në bllokun ish-komunist;
- Sfidat e stabilizimit ekonomik;
- Aspektet bazike të reformave strukturore;
- Transformimi i pronës dhe privatizimi;
- Vendet në tranzicion dhe BE.

### **Qëllimet dhe rezultatet e pritura:**

Qëllimi primar i lëndës është t'u jap studentëve një pasqyrë të qartë të sistemeve ekonomike, si dhe të rëndësisë të procesit të transformimit ekonomik nga ekonomitë e komanduara në ato me orientim nga tregu.

Studentët duhet të njohin kompleksitetin e procesit të transformimit nga ekonomi të centralizuara në ekonomi të tregut. Për më tepër, ata duhet të nxënë idenë themelore prapa reformave stabilizuese dhe atyre strukturore. Gjithashtu studentët duhet të tërheqin paralele me periudhën e post-tranzicionit në Kosovë.

### **Format e mësimdhënies dhe mësim nxënies:**

Që në fillim të mësimit studentëve iu komunikohet lënda, dhe të gjitha aspektet e tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e mesimit gjatë semestrit, përfshirë këtu edhe përgjegjësitë dhe obligimet edhe të mësimdhënësit dhe studentëve.

Studentët inkurajohen të janë pjesë aktive e mësimit përmes diskutimeve të ndryshme për secilin aspekt që ngritet brenda temave të caktuara dhe detyrave konkrete në mësim dhe në pjesën e ushtrimeve. Studentët obligohen të bëjnë punë hulumtuese studimore (shih më poshtë).

### **Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:**

Vlerësimi i studentëve bëhet gjatë mësimit përmes punës seminarike (që notohet) dhe të një testi në fund të lëndës. Studentët iu nënshtrohen provimeve në afatet e rregullta. Në notën përfundimtare përfshihet i gjithë aktiviteti i studenteve në mësime, përfshirë prezencën në mësime, aktivizimin në diskutim, detyrat, punën e pavarur, aktivitetin gjatë ushtrimeve, etj.

Me poshtë është dhënë struktura e vlerësimit gjatë procesit mësues (semestrit), dhe e vlerësimit pas procesit mësues:

<i>Aktivitetet</i>	<i>Notimi gjatë procesit mësues (ligjeratave/semestrit)</i>	<i>Notimi pas procesit mësues (ligjeratave/semestrit)</i>
Provimi	/	75% <sup>1)</sup>
Testi	35%	Të gjitha aktivitetet gjatë ligjeratave iu sigurojnë maksimumin 25%
Punimi seminarik <sup>2)</sup>	45%	
Pjesëmarrja	10%	
Ushtrime/detyra	10%	
<b>Gjithsej</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

*Vërejtje:*

- 1) Studentët të cilët i nënshtrohen provimit dhe nuk realizojnë asnjë nga aktivitetet gjatë semestrit notën maksimale që mund të marrin është **nota 8**.
- 2) Të gjitha detajet e dhëna më poshtë sa i përket punimit seminarik mbesin të finalizohen me asistencën e lëndës.

Përqindjet korespondojnë me notat në vijim:

Nota 10	⇒	Mbi 90%
Nota 9	⇒	80 - 89%
Nota 8	⇒	70 - 79%
Nota 7	⇒	60 - 69%
Nota 6	⇒	50 - 59%
Nota 5	⇒	Nën 50%

### **Mjetet e konkretizimit / TI:**

Mësimdhënia konkretizohet përmes ligjeratave, prezantimeve, punimeve seminarike dhe diskutimit të tyre, dhe përmes shembujve të ndryshëm konkret që vendosin një lidhje të qartë në mes të përvojave të vendeve të bllokut ish-socialist dhe Kosovës.

### **Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:**

Kujdes i veçantë i kushtohet raportit praktikë-teori. Për të konkretizuar mesimet teorike dhe për t'u njohur me tranzicionin e Kosovës studentët obligohen të kryejnë punime seminarike gjatë semestrit. Në raste të caktuara ftohen edhe mysafir nga bota akademike apo ajo e biznesit për të ndarë dijet e tyre me studentët.

### **Literatura:**

- Shënimet e pregaditura nga mesimdhënësi i lëndës;
- Lavigne, M. (1999), *The Economics of Transition: From Socialist Economy to Market Economy*, London: Macmillan (shih në bibliotekën e Fakultetit Ekonomik);
- Balcerowicz, L. (2001), *Post-Communist Transition: Some Lessons*, Thirty-first Wincott Lecture  
(<http://www.iea.org.uk/sites/default/files/publications/files/upldbook148pdf.pdf>).
- Kornai, J. (1992), *The Socialist System: The Political Economy of Communism*, Princeton: Princeton University Press;
- World Bank (1996), *World Development Report*, Washington DC: World Bank  
(<https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/5979>)

### **Literatura shitesë:**

Mesimdhënësi i lëndës do të pregaditë literaturë të caktuar për diskutim për të gjitha njësitë mësimore.

### **Udhëzues për punimin e esesë dhe prezentimin e saj**

Eseja duhet të shkruhet në grup (jo më shumë se 2 studentë) dhe nuk duhet të tejkaloj mbi 2000 fjalë (rreth 7 faqe). Në esenë tuaj ju duhet t'i kushtoni vëmendje disa aspekteve:

- Të ketë një strukturë të duhur, duke filluar me përshkrim të shkurtër të çështjes së cilën e trajton dhe cila është rëndësia e saj;
- Prezentimi dhe analiza e argumenteve duhet të bazohet në teoritë dhe idetë e qëndrueshme;
- Të analizojë pikpamjet e kundërta dhe të argumentohet një perspektive e caktuar në mënyrë logjike;
- Të identifikoni informatat e ndryshme dhe të përdorni vetëm ato relevante;
- Të mbaroni esenë me konkluzë.

Punimi duhet t'i ndjek me rigorozitet rregullat e shkrimit akedemik. T'i referoheni literaturës për rregullat e shkrimit akademik. Burimet në internet janë të shumta:

Shih: <https://owl.english.purdue.edu/owl/>

Sa i përket prezentimit, çështjet në vijim duhet të konsiderohen (edhe gjatë prezentimit duhet të keni kujdes për aspektet e perkufizuara në pikën më lart):

- Prezentimi duhet të jetë i argumentuar dhe të ketë diskutime të cilat janë të qarta për studentët tjerë që të kenë mundësi të përfitojnë duke ju dëgjuar juve;
- Të tregoni se keni bërë lexime të konsiderueshme rreth temës të cilën e keni trajtuar;
- Demonstron aftësinë tuaj të selektoni materialin relevant në fushë për ta prezentuar – mos harroni se keni vetëm 20 minuta për ta prezentuar punën tuaj;
- Realizohet me stil (mënyrë e përshtatshme e komunikimit me audiencën, kontakti me sy, sjelljet e përshtatshme, etj.), të jetë i qartë dhe të tregon vetëbesim (mos hezitoni të shihni audiencën; mos belbëzoni; mos bëni lëvizje të pakontrolluara; dhe mos lexoni nga shënimet);
- Involvon të gjithë anëtarët e grupit, në një formë apo një tjetër.

Nëse ju jeni pjesë e audiencës në prezentimin e ndonjë prej kolegëve tuaj, ti gjithashtu duhet të jesh i pregaditur për diskutim. Këto diskutime janë përsëritje dhe parapregaditje për provimin final apo testet që do të mbahen në ndërkohë.

Prezentimi gojor është një mënyrë shumë e mirë për t'ju pregaditur për intervista – ju duhet të jeni në gjendje të prezentoni në një kohë të kufizuar se keni njohuri të mjaftueshme të temës të cilën e trajtoni dhe jeni gjithashtu në gjendje t'ua komunikoni të tjerëve njohuritë tuaja.

Temat të cilat ju do t'i trajtoni janë të dhëna më poshtë, së bashku me datat kur do t'i prezentoni. Sicili student/grup duhet të përcaktohet për një nga vendet ne vijim: Shqipëri, Mal i Zi, Bosnje, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Bullgari, Slloveni, dhe Rumani. Nëse studenti nuk është i gatshëm të prezentoj në ditën e planifikuar, humb të drejtën për të prezentuar punimin, dhe me këtë edhe për t'u notuar.

Data e prezentimit	Tema	Sqarime shtesë rreth temës (çështjet që duhet hulumtuar)
--------------------	------	--

Java 5	Reformat e lidhura me liberalizimin e tregut	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregtia e jashtme gjatë periudhës së socializimit</li> <li>• Masat tarifore për mbrojtjen e industrive</li> <li>• Masat jo-tarifore për mbrojtjen e industrive</li> <li>• Marrëveshjet e tregtisë së lirë (anëtarësimi në OBT)</li> <li>• Tërhiqni paralele me Kosovën</li> </ul>
Java 6	Transformimi i pronës dhe privatizimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prona gjatë periudhës së socializimit</li> <li>• Metodatat e privatizimit të pronës</li> <li>• Institucionet bartëse të privatizimit</li> <li>• Rezultatet e procesit të privatizimit të pronës</li> <li>• Problemet/ vështërsitë gjatë procesit të privatizimit</li> <li>• Tërhiqni paralele me Kosovën</li> </ul>
Java 7	Reforma institucionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucionet gjatë periudhës së socializimit</li> <li>• Ligjet dhe përafrimi i tyre me <i>acquis</i>-in e BE-së</li> <li>• Mekanizmat për zbatimin e ligjit</li> <li>• Qeverisja dhe korrupsioni</li> <li>• Madhësia e aparatit qeveritar</li> <li>• Tërhiqni paralele me Kosovën</li> </ul>
Java 8	Reformimi i sistemit bankar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi bankar gjatë periudhës së socializimit</li> <li>• Reformat në sistemin bankar</li> <li>• Trashëgimia</li> <li>• Sistemi bankar dhe sektori privat</li> <li>• Tërhiqni paralele me Kosovën</li> </ul>
Java 9	Reformat në sistemin fiskal	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi tatimor në periudhën socialiste</li> <li>• Karakteristikat e politikës buxhetore në periudhën socialiste</li> <li>• Politika fiskale dhe stabilizimi i ekonomisë</li> <li>• Zhvendosja e prioriteteve të shpenzimeve</li> <li>• Politikatat tatimore dhe institucionet për mbledhjen e tatimeve</li> <li>• Tërhiqni paralele me Kosovën</li> </ul>
Java 10	Burimet njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Edukimi dhe sistemi shëndetësor në periudhën socialiste</li> <li>• Reformat në sistemin e edukimit</li> <li>• Reformat në sistemin e shëndetësor</li> <li>• Reformat në sistemin e edukimit</li> <li>• Tërhiqni paralele me Kosovën</li> </ul>

Java 11	Zhvillimi i sektorit privat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sektori privat në socializëm</li> <li>• Stimulimi i investimeve të huaja</li> <li>• Krijimi i kushteve për krijimin e NVM-ve</li> <li>• Insentivat për ndërmarrje të huaja dhe vendore</li> <li>• Tërhiqni paralele me Kosovën</li> </ul>
Java 12	Politika industriale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia e industrisë në socializëm</li> <li>• Rëndësia e industrisë në periudhën pas socializimit</li> <li>• Politikat mbështetëse të industrive</li> <li>• Subvencionet</li> <li>• Instrumentet tjera për përkrahjen e industrive vendore</li> </ul>

Burimet:

- EBRD Transition Report: <http://www.ebrd.com/pages/research/publications/flagships/transition.shtml>
- World Development Report 1996 (apo vitet në vijim): <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/5979>
- World Bank Business Environment Snapshots: <http://rru.worldbank.org/besnapshots/>
- World Bank World Development Indicators: <http://data.worldbank.org/data-catalog/world-development-indicators>
- The Catch-up index: <http://www.thecatchupindex.eu/TheCatchUpIndex/>
- World Bank Doing Business Indicators: <http://www.doingbusiness.org>.
- Burimet nacionale për vendet përkatëse.